

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Transparenca dhe integriteti në lobim, Komisioneri Dervishi: Publiku duhet të dijë kush ndikon në vendim marrje
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/15/transparenca-dhe-integriteti-ne-lobim-komisioneri-dervishi-publiku-duhet-te-dije-kush-ndikon-ne-vendimmarrje/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:15:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	15 shtator 2026, 10:09:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 15 shtator 2026, 10:08:00 UTC → 15 shtator 2026, 10:10:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	022b143338f51cdc9283e4e7a4bd284d174a39f8be84dd1522b3781b55e5c75a
TEKSTI	d1c8f5de703b73b8fbf1e079896102533b3562fc2599683917c6472bb0c793b9
PAMJA	c4efc23b3ea3c3056a22f1e013618c51034acf3809ce2283592dd80d951d446e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fe10142aeb43b539c48ffc1e5b8104151599de9d14517ef37a96ca0aca2864c2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0ae22dd21f6bca70f134e59ae1dafa22b8b5d83b679efc36f84697e742e9fc20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fe10142aeb43b539c48ffc1e5b8104151599de9d14517ef37a96ca0aca2864c2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SOCIALE TË FUNDIT

Transparenca dhe integriteti në lobim, Komisioneri Dervishi: Publiku duhet të dijë kush ndikon në vendimarrje

15/09/2026 12:09



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi takimin "Transparenca dhe Integriteti në Veprimtarinë e Lobimit", me fokus kuadrin e ri ligjor për lobimin në Republikën e Shqipërisë dhe paketën e projektakteve nënligjore që do të mundësojnë zbatimin e tij në praktikë.

Takimi u përshëndet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi; Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni; Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, znj. Giulia Re; si dhe Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, Sh.S. znj. Siri Walt. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike, partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile.

Në fjalën e tij, Komisioneri Dervishi theksoi se kuadri i ri për lobimin synon të rrisë transparencën mbi mënyrën se si interesa dhe aktorë të ndryshëm ndërveprojnë me vendimarrjen publike.

"Kur përmendet fjala Lobim, shpesh krijohet përshtypja se biseda kryhet në korridor të errët, mundësisht edhe me perde të rënda e të mbyllura. Kuadri i ri ligjor, por edhe objektivi ynë, është t'i japë dritë këtij mjedisi dhe të kemi një marrëdhënie të institucionalizuar.", u shpreh Komisioneri.

Dervishi nënvizoi se në një sistem demokratik është e natyrshme që vendimarrësit të dëgjojnë ekspertizën dhe interesat e grupeve të ndryshme, ndërsa problemi lind kur ndikimi mbetet i padukshëm ose kur mundësia për t'u dëgjuar perceptohet si privilegj i një numri të kufizuar aktorësh.

"Në një sistem demokratik, interesat trokasin në derën e vendimarrjes. Por, publiku duhet ta dijë kush trokiti, për kë dhe për çfarë", theksoi ai.

Ligji nr. 12/2026 "Për Lobimin në Republikën e Shqipërisë" i ka ngarkuar Zyrës së Komisionerit mbikëqyrjen e kuadrit të ri dhe kompetencën për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore. Komisioneri theksoi se kjo përgjegjësi e re nuk është e shkëputur nga roli që institucioni ushtron prej vitesh si garant i së drejtës për informim, por lidhet drejtpërdrejt me transparencën, aksesin në informacion dhe llogaridhënieën e institucioneve publike.

"E drejta e informimit i mundëson publikut të njohë vendimet dhe dokumentet, ndërsa transparenca e veprimtarisë së lobimit bën të dukshme rrugën e ndikimeve që u paraprin vendimeve. Të dyja i shërbejnë një pushteti publik më të hapur dhe më të përgjegjshëm", deklaroi Dervishi.

Gjatë aktivitetit u prezantua paketa me tetë projektakte nënligjore, e hartuar me ekspertizën e Këshillit të Evropës dhe financimin e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe

Kryesore



Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

11:06

Dosja "Revanshi" / GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë

09:32

Cënuan perimetritin e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë

10:39

Vuçiç zbulon datën e dorëheqjes, presidenti i Serbisë: Fushatën e vazhdoj si qytetar i thjeshtë

11:34

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

09:50

Më të lexuarat

Mbyllet gjyqi ndaj Thaçit në Hagë! Procesi për pengim të drejtësisë, mbrojtja kundërshtoi transkriptet e prokurorisë dhe kërkoi pafajësi

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsit dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënime kryesore

"China Zorrilla", anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet në tetor

"O kukull, projektligji për kinemanë do deformatë filmin duke futur video-lojëra", Mevlan Shanaj përballë live në "Ftesë në 5" me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë

"FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s'kishte prova", Filip Çakuli: Veliajn e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

Nga një 'like' në Instagram te propaganda

Bashkëpunim. Aktet përcaktojnë në mënyrë konkrete funksionimin dhe administrimin e Regjistrimit të Lobimit, procedurat e regjistrimit, deklarimin e veprimtarisë së lobimit, identifikimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit, verifikimin dhe përditësimin e të dhënave, administrimin e dokumentacionit, si dhe standardet e sjelljes.

Komisioneri Dervishi e cilësoi këtë fushë të re përgjegjësie si një sfidë institucionale dhe rregullatore, duke vënë në dukje se rregullimi i lobimit vijon të zhvillohet edhe në vende të tjera dhe se nuk ekziston një model unik që mund të zbatohet mekanikisht në çdo sistem.

Sipas tij, Shqipëria duhet të përfitojë nga përvojat e vendeve që kanë ngritur më herët sisteme të tilla, por njëkohësisht të ndërtojë një mekanizëm që i përgjigjet kuadrit ligjor dhe realitetit shqiptar.

Në vijim të takimit u diskutua mbi transparencën e lobimit dhe integritetin në vendimarrje nga perspektiva e politikave publike, standardet dhe praktikat evropiane për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor, si dhe perspektiva e shoqërisë civile mbi transparencën, pjesëmarrjen dhe integritetin në vendimarrje. Në panel kontribuan përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, Këshillit të Evropës dhe Lëvizjes Evropiane në Shqipëri.

Aktiviteti vijoi me një diskutim të hapur, ku pjesëmarrësit patën mundësi të paraqesin pyetje, komente dhe rekomandime mbi paketën e projektakteve dhe mënyrën e funksionimit të sistemit të ri të lobimit.

Kontributi i institucioneve publike, ekspertëve, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe aktorëve që do të ndërveprojnë me sistemin e lobimit do të jetë i rëndësishëm për ndërtimin e një mekanizmi funksional, transparent dhe të zbatueshëm në praktikë.

Top Channel

serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë

Pikë referimi për shqiptarët në Itali/
Inaugurimi i Konsullatës së Nderit të
Shqipërisë, kryeministri Rama në Napoli për
ceremoninë

I Sociale »



Depistimi i fëmijëve me aftësi ndryshe në shkollë, ministria Spahiu: Protokolle të qarta edhe për trajtimin në vijueshmëri

15/09 11:12



Alarmi për bombë në shkollën "Edith Durham", reagon zv.kryeministria Koçi: Një çmenduri e mirëfilltë kriminale

14/09 18:06



Viti i ri arsimor sjell 6 shkollë të reja në Tiranë, ambiente dhe kapacitete të reja për nxënësit e kryeqytetit

14/09 08:39




Nga Hollywoodi në Shkodër, historia e amerikanes Midian Crosby që ka gjetur në Shqipëri pasionin për gatimin

13/09 20:24



Të huajt studiojnë në Durrës/ Studentët nga Europa, Azia dhe Afrika janë regjistruar në Universitet

13/09 15:45



Rritet dhuna ndaj grave në Elbasan/ Dyfishohet numri i atyre që kërkojnë urdhër mbrojtjeje, alarm edhe për dhunën digjitale

13/09 15:38

Na ndiqni:



I Video »





Top Channel/ "Frika nga AI, një mashtrim": Trump kundërshton regullat mbrojtëse!



Top News – Kushtetuesja nuk bind Gjykatën e Lartë. Kolegji ië në fuqi 'arrestin me burg' për Veliajn



Top Channel/ Ngërçi politik në Kosovë, SHBA e pakënaqur: Po pengon axhendën e përbashkët!



Top Channel/ Debate te "Xhafaj", kryetari: Rastet të trajtohen, kam bërë 7 ankesa për zhurmën dhe...



Top News – Pak orë nga vendimi për Thaçin. Por transmetimi 'live' do të jetë 10 minuta me vonesë



Top Channel/ Vucic: Jap dorëheqjen në 27 shtator, fushatën e vazhdoj si qytetar i thjeshtë!

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Bileta
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.